V E N D I M
Nr. 195, datë 20.3.1998

PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE QË NUK MUND TË TRANSFORMOHEN

(Ndryshuar me vendimin nr. 447, datë 9.7.1998)

(I përditësuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", ndryshuar me ligjin nr.8159, datë 7.11.1996, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Objekti i këtij vendimi janë ndërmarrjet, të cilat sot për sot e kanë ndërprerë veprimtarinë ekonomike dhe nuk plotësojnë kriteret e transformimit në shoqëri tregtare, në zbatim të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëritë tregtare", ndryshuar me ligjin nr.8237, datë 1.9.1997 dhe ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

2. Lista e ndërmarrjeve me të dhënat *dhe propozimet përkatëse për privatizim* i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nga organet qendrore dhe pushteti lokal, sipas vartësisë administrative të ndërmarrjeve.Kjo listë *miratohet dhe* publikohet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit

3. Format e privatizimit janë:

- shitja;
- shitja me rezervë;
- kontrata e enfiteozës;
- *kontrata e qirasë.*

4. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, pasi shqyrton dokumentacionin e privatizimit të ndërmarrjes, të përgatitur sipas pikës 7 të këtij vendimi, nxjerr urdhrin për miratimin dhe publikimin e formës së privatizimit. Ky urdhër së bashku me dokumentacionin përkatës, përcillet në institucionet e përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij vendimi, për kryerjen e procedurave përkatëse.

5. Për shitjen dhe shitjen me rezervë ngarkohet AKP-ja ta realizojë atë në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 20.3.1998 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedura e shitjes".

6. Kontrata e enfiteozës lidhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit sipas dispozitave të Kodit Civil në fuqi. *Kontrata e qirasë lidhet sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.430, datë 9.7.1998 "Për dhënien me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive a institucioneve shtetërore".*

7. Vlerësimi i kapitalit të ndërmarrjeve dhe dokumentacioni përkatës për privatizim përgatiten sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 20.3.1998 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohen, si dhe procedura e shitjes". Afatet e vlerësimit përcaktohen me urdhër të Ministrit. Për drejtuesit që pengojnë procesin e privatizimit, të merren masa disiplinore sipas nenit 7 të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqërie tregtare", ndryshuar me ligjin nr. 8237, datë 1.9.1997.

8. Ndryshimet në kapitalet e ndërmarrjeve për nevojë të ristrukturimit bëhen me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano